

V E N D I M
Nr. 183, datë 15.4.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.723, DATË
19.11.1998 “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7889, DATË 14.12.1994 “PËR STATUSIN E
INVALIDIT””**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Në pikën 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.723, datë 19.11.1998 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikantëve, edhe ata invalidë, që nuk përcaktohen si të tillë në nenin 1,të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit”, por që për arsye riaftësimi janë pajisur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me mjete motorike, para vitit 1994.”

2.Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1.1.1999 dhe përballohen nga buxheti i vitit 1999 për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko